

NJOFTIM PUBLIK

NË LIDHJE ME VENDIMIN E MARRË NGA KOMISIONI I PAVARUR AD-HOC PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISE NGA RADHËT E AVOKATËVE

Në institucionin e Avokatit të Popullit, në datë 29.12.2023, ora 16.00 u zhvillua mbledhja e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për marrjen e vendimit për renditjen e kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve.

Bazuar në nenet 34 dhe 132, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me përfundimin e procedurës së vlerësimit të kriterëve profesionale dhe morale si dhe caktimit të peshës specifike të tyre, Komisioni i Pavarur Ad-Hoc shpall listën e kandidatëve sipas renditjes, duke filluar nga kandidatët që kanë marrë pikët më të larta si vijon:

RENDITJA E KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NGA AVOKATIA

1. Eris Hysi
2. Përparim Kalo
3. Erind Merkuri
4. Alban Alimema
5. Erind Gërmenji
6. Fatos Lazimi
7. Entela Shehaj (Memishaj)
8. Saimir Vishaj
9. Albana Tushe
10. Albens Tabaku
11. Klodian Gjermeni (Gjermëni, Gjermëni)
12. Artan Reçi
13. Bledar Bajri (Boshnjaku)

RENDITJA E KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

1. Përparim Kalo
2. Erind Merkuri
3. Alban Alimema
4. Erind Gërmenji
5. Entela Shehaj (Memishaj)
6. Saimir Vishaj
7. Albens Tabaku
8. Artan Reçi
9. Bledar Bajri (Boshnjaku)

Në përputhje me nenet 35 dhe 133, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Avokati i Popullit, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad-Hoc, do t’i përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit listën me emrat e renditur të kandidatëve si dhe listën me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore, së bashku me raportin e vlerësimit.

Me përfundimin e kësaj procedure, konsiderohet e përfunduar puna e Komisionit të pavarur Ad-Hoc në lidhje me procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve.